

## INTERVISTA E KRYETARIT TË PREZENCËS ME TV ORA NEWS

*Drejtëpërsëdrejti në 'Tonight me Ilva Tare', 15 Shtator*

**Pyetje: Pikërisht një vit më parë, më 16 shtator, ju erdhët në Shqipëri në postin e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së. Çfarë ju kishin thënë për Shqipërinë përpara se të mbërrinit këtu?**

....se kishte nevojë për mbështetje dhe se ishte një vend i përkushtuar ndaj angazhimeve të OSBE-së, kështu që prisja të ishte një post interesant, dhe mund të them se kështu është vërtet. Ka qenë një vit mahnitës, në shumë aspekte, që nga fillimi i punës me njerëzit. Shqiptarët janë njerëz shumë të mirë dhe më pëlqen të punoj këtu.

**Pyetje: Por cila ishte përshtypja e parë, më mbresëlënëse që patët kur erdhët në Shqipëri?**

U ndjeva i mirëpritur që ditën e parë. Siç e përmendët dhe ju, unë erdha në Shqipëri më 16 shtator 2010, dhe që nga dita e parë e punës – sa shkela në zyrë, duke folur me kolegët, me njerëzit dhe me homologët politikanë...u ndjeva i mirëpritur. Ka qenë një vit interesant, sfidues, por edhe shpërblyes. Megjithatë nuk ka përfunduar ende. Nuk dëshiroj të them shumë që tani, por mund të them se është patjetër e rëndësishme të jesh këtu në këtë periudhë.

**Pyetje: Qëllimi i Prezencës së OSBE-së, si gjatë vitit të kaluar, por edhe në përgjithësi, është promovimi i demokratizimit, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut, si dhe konsolidimi i institucioneve demokratike në përputhje me parimet e OSBE-së, edhe në vende të tjera. Si po i zbaton Shqipëria këto parime që nga koha kur ju erdhët si Kryetar i Prezencës?**

Shqipëria ka një legjislacion të rëndësishëm, duke filluar me Kushtetutën, i cili funksionon mjaft mirë. Por sigurisht që është ende një vend në zhvillim dhe duke marrë hapat e mëtejshme për t'u integruar edhe më shumë në strukturat evropiane, si dhe për t'u shndërruar në një shtet edhe më modern çdo ditë e çdo muaj që kalon. Kjo është punë gjithëpërfshirëse dhe shumë komplekse. Nevojiten reforma dhe bashkëpunim në shumë faza, sepse edhe sipas Kushtetutës: Qeveria dhe Opozita duhet të bashkëpunojnë për pjesë të rëndësishme të legjislacionit që kërkojnë një shumicë votash prej 3/5. Kështu që bashkëpunimi mbetet një pjesë shumë e rëndësishme në politikën shqiptare...

**Pyetje: Do t'i kthehemi në fakt përsëri kësaj teme më vonë gjatë intervistës. Ditët e fundit ju prezantuat në Vjenë raportin vjetor të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. A pati komente nga partitë politike shqiptare në lidhje me këtë raport?**

Ajo çka kam dëgjuar është se raporti bën një përshkrim të mirë të asaj që ka ndodhur, duke dhënë gjithashtu një pamje të përgjithshme e duke krijuar edhe një nivel më të lartë ndërgjegjësimit. Por më e rëndësishme se e kaluara, mendoj se është e tashmja dhe e ardhmja – pra ku do të shkojmë nga tani e tutje. Dhe këtu mendoj se *emri i lojës* është dialog, dialog dhe vetëm dialog.

**Pyetje: Meqë ra fjala te dialogu, në raportin tuaj thuhet se problemi kryesor politik ka qenë vazhdimi i ngërçit politik që nga vjeshta e vitit 2009. Cili ka qenë kontributi juaj në krijimin e një ure lidhëse për dialog midis partive politike?**

Shumë shpejt pas ardhjes sime nisa të shfrytëzoja vizitat dhe takimet për të theksuar nevojën për reformë zgjedhore. Në mos të plotë, ne do të kishim dashur të shihnim të realizohej të paktën një pjesë e kësaj reforme para zgjedhjeve vendore. Dhe një nga përpjekjet, që të paktën u bë konkrete në një prej takimeve, ishte tryeza e rrumbullakët e kryetarëve të partive më 22 tetor 2010. Kjo tryezë e rrumbullakët ishte një ngjarje e rëndësishme. Ishte i pranishëm kryetari i partisë socialiste, kryetari i partisë demokratike dhe kryetarët e partive të tjera, si dhe një pjesë e mirë e shoqërisë civile. U duk se dialogu ishte i mundur, por nga ana tjetër zgjedhjet po afroheshin, si dhe pati shumë ngjarje të tjera, dhe tani jemi afër ardhjes së një vjeshte tjetër me një mundësi për rifillimin e dialogut. Shenjat duken shumë inkurajuese, por gjithsesi më shumë duhet bërë.

**Pyetje: Më lejoni z. Ambasador të citoj një pjesë nga raporti juaj ku thuhet se “Vetëm kur të gjitha palët të fillojnë të kuptojnë plotësisht se çfarë do të thotë në të vërtetë të jesh në *Qeveri* dhe çfarë do të thotë të jesh në *Opozitë* në një sistem demokratik, do të mundet Shqipëria të bëjë një përparim domethënës në axhendën e reformave”. Ju jeni vazhdimisht në kontakt me politikanët shqiptarë. A mendoni se është arritur më në fund të kuptohet një gjë e tillë– pra se çfarë do të thotë të jesh në *Qeveri* dhe çfarë do të thotë të jesh në *Opozitë*?**

Një pjesë është arritur, dhe këtu përfshihet një pjesë e rëndësishme. Por nuk është e plotë. Për një bashkëpunim të vërtetë është e rëndësishme që si *Qeveria* dhe *Opozita* të gjejnë gjuhën e përbashkët për ta çuar vendin përpara. Dhe integrimi evropian është një proces që ka nevojë për gjetjen e një gjuhe të përbashkët. Për vendimmarrjen kyçe nevojitet shumë unanimitet dhe konsensus – çfarë mund të arrihet nëpërmjet dialogut, në mënyrë që kjo në fund të çojë në marrjen e vendimeve për ato pjesë të legjislacionit që kërkojnë një shumicë të cilësuar prej 60% ose 3/5. Kështu që një *Qeveri* e vërtetë dhe një *Opozitë* e vërtetë do të përjashtonin çdo betejë politike kur bëhet fjalë për integrimin evropian, dhe do të paraqisnin argumentet e tyre në një dialog të orientuar drejt zgjidhjeve. Është shumë e rëndësishme të arrihet në këtë zgjidhje, të ndihet përgjegjësia dhe, së fundi, të jepet rezultati i pritshëm që do ta çojë Shqipërinë dhe shqiptarët përpara.

**Pyetje: Ka gjithmonë një debat, veçanërisht në sytë e publikut, se cila duhet të tregohet më tolerante – *Qeveria* apo *Opozita* – në lidhje me vendimet dhe deklaratat që duhet të bëjnë. Cili është komenti juaj për këtë – kush duhet të tregohet më shumë tolerant?**

Më lejoni të them se t'i shtosh dialogut politik shije, e ta bësh edhe pak pikant, jo vetëm që është legjitime, por edhe e rëndësishme për të tërhequr interesin e publikut. Dihet që *Qeveria* ka çdo të drejtë politike dhe ligjore të jetë në udhëheqje – sepse për këtë është zgjedhur, por duhet të tregohet edhe më tepër e disponueshme, sepse ndodhet në një farë mënyre në pozicion më të rehatshëm, duke qenë në pushtet. Dhe sigurisht që nevojitet respekt dhe më shumë tolerancë për ta afruar dhe për ta përfshirë opozitën. Nga ana tjetër, edhe opozita duhet të përgjigjet me të paktën të njëjtën shkallë respekti dhe të bëjë të pamundurën për të shmangur luftën politike atëherë kur palët duhet të bashkohen dhe të arrijnë një zgjidhje të përbashkët. Mendoj se mirëkuptimi dhe respekti i dyanshëm, si dhe përfshirja në dialog real janë thelbësore.

**Pyetje: Por kemi dhe faktin tjetër, e të qenit në një ngërç politik që nga vjeshta e vitit 2009. Dhe jam e sigurt që e keni ndarë këtë mendim edhe me politikanët shqiptarë. A duhet të bëjmë dikë përgjegjës për këtë ngërç?**

Do të thosha se përgjegjësia duhet ndarë. Unë nuk jam këtu për të rihapur llogaritë, sigurisht që jo pas një viti, dhe ndoshta as më vonë. Mendoj se është e rëndësishme të shohim drejt së ardhmes. Të dyja palët i kanë shprehur opinionet dhe pikëpamjet e tyre për ngjarjet e ndodhura. Tani është momenti dhe koha e duhur, gjë që e kam shprehur qartë edhe në raportin tim mbajtur para shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së në Vjenë javën e kaluar, se është koha t'i hedhim sytë nga e ardhmja. Ka kaluar mjaft kohë dhe dialogu është tashmë loja që duhet nisur; fokusi duhet të jetë integrimi evropian dhe kjo kërkon mirëkuptim dhe gjetjen e një gjuhe të përbashkët nga të dyja palët.

**Pyetje: Një përshtypje personale në fakt, pasi lexova raportin tuaj, ishte se ky është i pari raport i OSBE-së që përcjell një mesazh të qartë. Në përfundim të raportit ju shpreheni se mesazhi është i thjeshtë: “Mjaft kohë është humbur deri tani. Nëse vërtet doni t’i tregoni publikut shqiptar dhe partnerëve tuaj ndërkombëtarë se i merrni seriozisht përgjegjësitë dhe detyrimet tuaja, atëherë kjo është koha për t’iu kthyer punës me axhendën politike...” Si reagon politikanët shqiptarë ndaj këtij mesazhi?**

Ajo çfarë po ndodh këtë javë është shumë e rëndësishme. Parlamenti filloi të mbledhet përsëri pas pushimeve të verës. Dhe prania e të gjitha partive politike, e të gjithë deputetëve nga të dyja anët e bënë këtë një fillim të rëndësishëm. Tani është i nevojshëm dialogu dhe një prezantim konstruktiv idesh të mira, dhe projekt ligjesh të mira për integrimin evropian, dhe kjo sapo ka filluar. Reagimet nga parlamentarët, politikanët, në përgjithësi ishin mjaft të dukshme. Secili, qoftë hapur apo në mënyrë indirekte, pranoi se nevojitet një punë konstruktive për të ecur përpara. Nga ana tjetër, ka edhe çështje të tjera të rëndësishme që duhen zgjidhur më parë. Por tani, pas pushimit të verës, kam përshtypjen se situata është përmirësuar dhe po shihet më shumë drejt së ardhmes në krahasim me më parë. Pra ka filluar një periudhë më konstruktive dhe shpresoj të mos e kem gabim.

**Pyetje: Le të shpresojmë... Në raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR-it, për zgjedhjet e 8 majit 2011, thuhet se për zgjedhjet në Tiranë gjykimi i apelimeve në Kolegjin Zgjedhor gjatë periudhës pas zgjedhore paraqiti një tablo të ndryshueshme. Z. Ambasador, çfarë do të thotë një tablo e ndryshueshme?**

Në fakt kjo pyetje duhet t’i drejtohet ODIHR-it. Z. Stonestreet ishte këtë javë në Tiranë për të shpjeguar edhe disa nga këto aspekte. Nëse më kujtohet mirë, në Kolegjin Zgjedhor u depozituan rreth 56 apeline. Raporti i ODIHR-it, jo imi, thotë se ishte një tablo e ndryshueshme. Mendoj se kjo i referohet kryesisht zgjedhjeve në Tiranë dhe mendoj se sqarohet në raport.

**Pyetje: Kur thoni se ishte raporti i ODIHR-it dhe jo i OSBE-së, do të thotë se mendoni ndryshe nga ODIHR-i?**

Ata kanë rolin kryesor kur bëhet fjalë për vëzhgimin e zgjedhjeve, dhe punojnë nën OSBE-në ashtu si dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri; pra, jemi vëllezër që ndajmë punën: ata bëjnë vëzhgimin, ne ofrojmë mbështetje, si për shembull me reformën zgjedhore. Reforma zgjedhore është pjesë e mandatit tonë, dhe ne kemi detyrën të ndihmojmë me reformën e kodit zgjedhor.

**Pyetje: Gjatë një takimi që kryetari i Opozitës, z. Rama pati me z. Stonestreet, z. Rama tha se raporti i ODIHR-it ishte objektiv, i qartë dhe ndihmoi në një farë mënyrë në qetësimin e tensionit politik. Jeni i të njëjtin mendim?**

Mendoj se është një këndvështrim i rëndësishëm i një prej politikanëve kyç të vendit dhe patjetër që nuk duhet nënvlerësuar.

**Pyetje: Shumica e rekomandimeve në raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e 2009-s, si dhe rekomandimet e opinionit të përbashkët ligjor të OSBE/ODHIR-it dhe Komisionit të Venecias po për zgjedhjet e 2009-s vlejné edhe për zgjedhjet vendore të vitit 2011. Cili do të jetë roli i OSBE-së për të siguruar kryerjen e këtyre reformave përpara zgjedhjeve të ardhshme në vitin 2013?**

Është një nga deklaratat që kam përsëritur dhe që do të vazhdoj ta them qartë: ka ardhur koha të shfrytëzojmë javët dhe muajt në vazhdim për të diskutuar ndryshimin e kodit zgjedhor dhe për të përdorur sa më mirë kohën e mbetur deri në mes të vitit tjetër, sepse jemi përpara shumë ngjarjeve, një prej të cilave është edhe 100 vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 2012. Por edhe më me rëndësi për vitin 2013 janë zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe legjislacioni, veçanërisht pjesët kyçe të tij siç është edhe kodi zgjedhor, që duhet të jetë gati përpara afrimit të zgjedhjeve, dhe idealja do të ishte një vit përpara zgjedhjeve. Pra, koha ideale për të parë një vendimmarrje përfundimtare për kodin e ri zgjedhor do të ishte qershori 2012.

**Pyetje: Jam mësuar në fakt me idenë se gjërat ideale nuk ndodhin asnjëherë, apo që idealizmi nuk është një tipar që karakterizon shqiptarët. Çfarë do të ndodhë nëse...**

Por mund të ndodhë. Këtë e them me sinqeritet. Unë vij nga Evropa veriore dhe shoh se në Shqipëri ka elemente shumë të mirë. Një prej tyre është stina e verës, e cila mungon në veri të Evropës. Kjo është diçka pozitive. Pra, ka disa gjëra ideale – njerëzit janë optimist dhe shprejnë që klasa politike të japë rezultate. Dhe unë jam i sigurt që kjo është e mundur. Politikanët e kanë kuptuar se duhet të ecin përpara.

**Pyetje: Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it përmban edhe një sugjerim për të ndryshuar formulën e përbërjes së Komisionit Qendror Zgjedhor, në mënyrë që të rritet besimi në pavarësinë e tij dhe për zbatimin e paanshëm të Kodit Zgjedhor nga ana e tij. Cila do të ishte një formulë e mirë për Shqipërinë? Çfarë sugjeroni ju?**

Sugjerimin përfundimtar do t'ia lija partive politike të përfshira. Por ndoshta një sugjerim do të ishte të rishikonim edhe një herë modelet që kanë ekzistuar më parë në Shqipëri. Modeli aktual lë praktikisht çdo gjë në dorë të dy kampeve kryesore; shtatë anëtarë, të shtatë të emëruar nga partitë politike. Përpara ndryshimeve në vitin 2008, partitë nuk kishin shumicën. Palë të tjera mund të emëronin, si për shembull gjyqtarët ose Presidenti i Republikës, kështu që përbërja ishte më e larmishme, dhe disa prej zhvillimeve që pamë gjatë përgatitjeve për zgjedhjet e 8 majit mund të kishin ndodhur me sistemin e vjetër. Kështu që ndoshta ia vlen të shohim dhe krahasojmë eksperiencën e fundit me ato të mëparshme, si dhe ndoshta të marrim disa elemente nga modelet e vjetra në mënyrë që të arrijmë në zgjidhje më pak të vetjake.

**Pyetje: A keni një recetë të gatshme që mund t'ua sugjeronit politikanëve shqiptarë për formulën e përbërjes së KQZ-së?**

Do ta kufizojta tek drejtimet – të mos lihet në dorë të partive politike, por të përfshihen edhe institucione të tjera të rëndësishme si Presidenti i Republikës, në mënyrë që të jenë më tepër teknike sesa për interesa vetjake. Pjesa tjetër i takon diskutimeve midis aktorëve kryesore.

**Pyetje: Ka pasur një debat përpara zgjedhjeve. Ka ekzistuar gjithmonë mendimi për të pasur një KQZ të përbërë nga përfaqësues të administratës civile dhe nëpunësve civil. Mendoni se është një zgjidhje e mirë?**

Është një zgjidhje e mundshme. Dhe nëse bien dakord të gjithë aktorët politik, ose të paktën shumica e tyre, atëherë mund të ishte një zgjidhje. Por nuk shoh nevojën për të përjashtuar partitë politike plotësisht nga KQZ-ja. Një nga modelet e mëparshme ka qenë të paktën një anëtar nga çdo kamp, e cila është e nevojshme edhe nga ana e transparencës. Do të ishte e logjikshme të gjendej kombinimi i duhur. Vlen që të diskutohet dhe kjo duhet bërë nga kryetarët do të thosha – sigurisht me ndihmën e ekspertëve dhe të shoqërisë civile.

**Pyetje: Z. Ambasador, në intervistën e parë në këtë studio, në 24 maj, ndërsa po diskutonim zgjedhjet në Tiranë, ju thatë se gabimet janë njerëzore –duke iu referuar hedhjes së votave në kutinë e gabuar, por atëherë nuk pranuat të komentoni për vendimin e KQZ-së për hapjen e atyre kutive. Ju thatë në atë kohë se numërimi i votave ishte korrekt. Të dëgjojmë një insert të shkurtër nga intervista dhe të rikthehemi në studio. Ja ku jemi përsëri. Në raport ju shpreheni se kodi zgjedhor duhet të ndryshohet për të adresuar vlefshmërinë e fletëve të votimit të hedhura në kutitë e gabuara, procedurat për të përfshirë këto vota në tabelën e rezultateve dhe procedurat që duhen ndjekur në rast mospërputhjes mes numrit të votave të hedhura në kuti dhe numrit të firmave në listat e zgjedhësve. A mund të jepni një formulim konkret të këtyre procedurave? Dua të them fakti që nuk ishte parashikuar për këto zgjedhje, por që u zbatua. A sjell kjo dyshimin se nuk ishte e drejtë të përdorej këtë herë meqë nuk kemi procedura konkrete për këtë aspekt të veçantë të votave të hedhura në kutitë e gabuara?**

Jo çdo gjë duhet përkufizuar; të paktën kështu ndodh në nivel ndërkombëtar dhe gjithashtu në vendin tim, në Gjermani. Kur diçka bëhet në frymën e duhur, është e drejtë. Kur shihet vullneti i shprehur i votuesve ditën e zgjedhjeve, dhe kjo bëhet hapur, atëherë nën rrethana normale, mund të pranohet plotësisht. Ju pyetët se çfarë do të rekomandoja për të ardhmen. E theksoj përsëri se është më e rëndësishme që partnerët, dhe them qëllimisht partnerët dhe kundërshtarët në zgjedhjet e ardhshme të bien dakord sesi të organizohen, ndaj nuk dëshiroj të jap propozime apo receta të gatshme. Megjithatë, ka një sërë zgjidhjesh të mundshme, si për shembull hedhja e të gjitha votave në një kuti të vetme, dhe për këtë duhet rregulluar procedura e numërimit, në mënyrë që të jetë më e lehtë për numëruesit – sepse nuk ka qenë e tillë në të kaluarën. Kur vendoset që të mbahen katër kuti, si në rastin e Tiranës, për dy nivele të ndryshme, mund të veprohet në mënyrë të tillë që të hapen të gjithë kutitë, të ndahen fletët e votimit, të organizohen në grupet përkatëse dhe pastaj të numërohen, për të shmangur kështu vota të pavlefshme të harruara apo të lëna pa numëruar. Kjo do të ishte në përputhje me leximin e përgjithshëm të kushtetutës, që çdo votë duhet trajtuar si e barabartë dhe të numërohet, dhe si e tillë do të ishte konsistente. Nga përvoja me zgjedhjet e kaluara, vlen që kjo pikë të rishikohet shumë më përpara zgjedhjeve të ardhshme dhe të qartësohet, në mënyrë që të shmangim një konfuzion të ngjashëm.

**Pyetje: Por sipas jush, sipas mendimit tuaj, a nuk ishte pikërisht ky konfuzion që ndikoi edhe rezultatin e zgjedhjeve?**

Ishte një garë me rezultat shumë të ngushtë, dhe sigurisht që çdo votë kishte rëndësi. Mund të them personalisht se këto ishin zgjedhjet më dramatike që kam parë ndonjëherë nga afër, për sa i përket rezultatit. Ne e pamë çfarë ndodhi në fund të numërimit në 14 maj dhe sesi shkoi rezultati pas numërimit të votave të hedhura në kutitë e gabuara – kishte një diferencë votash që solli në fakt ndryshimin. Kështu që kjo çështje duhet qartësuar sa më mirë të jetë e mundur.

**Pyetje: Të gjithë partitë politike duhet ta lexojnë raportin e OSBE/ODIHR-it në tërësi, duke shmangur tundimin për të përzgjedhur vetëm elementet e pëlqyeshme apo të papëlqyeshme. Më pëlqen kjo pjesë e raportit sepse duket se keni ndjekur me kujdes se çfarë ka ndodhur në të kaluarën me raportet ndërkombëtare, veçanërisht me raportin e OSBE-së. Pse ishit të shqetësuar se mund të tregoheshin përzgjedhës në lexim?**

Kur e lexon një fjali jashtë kontekstit mund të ketë ose të duket sikur ka një kuptim plotësisht tjetër. Prandaj është e rëndësishme që raporti i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet të lexohet rresht për rresht. Disa nga këto *përzgjedhje selektive* pasazhesh i kemi parë edhe në të kaluarën, dhe mund të kenë qenë çorientuese. Mund të krijohet përshtypja se secila palë ka të drejtë, kështu që s'duhet bërë asgjë. Por kjo sigurisht nuk është e vërtetë. Ne, ose vendi ka nevojë për një reformë zgjedhore për të përmirësuar zgjedhjet në të ardhmen, për t'i bërë më të sigurt dhe të besueshme.

**Pyetje: A shërbeu edhe si një shenjë për të treguar se i gjithë spektri politik ka pjesën e vetë të përgjegjësisë?**

Përgjegjësia duhet ndarë. Siç e thashë, qeveria duhet të jetë më e disponueshme ndaj opozitës; opozita duhet të jetë konstruktive dhe jo të qëndrojë e veçuar pa sjellë asnjë propozim të mirë. Në 12 muajt e fundit ka pasur oferta edhe nga qeveria që opozita të bënte propozimet e veta të cilat më pas do të miratoheshin. Nuk është aq e lehtë në fakt. Është shumë e rëndësishme që të gjenden zgjidhje të përbashkëta dhe të zhvillohen bashkërisht, sepse herët a vonë në demokraci gjërat ndryshojnë. Ata që janë sot në opozitë mund të vijnë në pushtet gjatë zgjedhjeve të ardhshme ose edhe më vonë. Sistemi duhet të funksionojë në mënyrë transparente nga të dyja anët, ndaj nevojitet një shkallë e lartë konsensusi. Kjo mund të arrihet nëse të dyja palët gjejnë një zgjidhje.

**Pyetje: Ju thoni gjithashtu se një reformë e plotë duhet të jetë: a) teknikisht e shëndoshë; b) e konsultuar gjerësisht dhe, sigurisht, e panxituar; dhe c) sa më konsensuale. Z. Ambasador, cili do të jetë roli i OSBE-së në reformën e ardhshme, duke pasur parasysh faktin që herën e fundit reforma elektorale u zhvillua nga z. Gjinkuri dhe z. Bylykbashi, pa ndonjë këshillim apo konsulentë nga OSBE-ja?**

Kjo ka ndodhur kohë përpara ardhjes sime. Me sa di unë ka pasur edhe disa komunikime, por duhet të kishte pasur edhe më tepër. Ajo çfarë ne ofrojmë për të ardhmen, por edhe për të tashmen, është asistencë jonë – duke ofruar ekspertizë apo edhe propozime. Por së pari, janë partnerët tanë politik që duhet të fillojnë të prezantojnë idetë dhe konceptet e tyre, dhe pastaj ne mund të ofrojmë ndihmën tonë më mirë. Ajo çfarë duhet të kemi gjithmonë parasysh, dhe si më e rëndësishmja, është Shqipëria. Kjo është e qartë. Zgjidhjet më të mira dhe më të qëndrueshme gjenden kur shqiptarët të jenë të bindur se e mira është që zgjidhjet të mos vijnë nga jashtë. Natyrisht modelet që ekzistojnë diku tjetër mund të analizohen, shqyrtohen dhe verifikohen nëse janë të mira për t'u përdorur këtu në Shqipëri, për shembull këtu ekziston

një mundësi e mirë që ne të ndihmojnë në këtë drejtim. Mirëpo, ajo se çfarë nevojitet apo se çfarë është më e mira, këtyre pyetjeve, pra, vetëm Shqiptarët mund t'u japin përgjigjen më të mirë.

**Pyetje: Kohët e fundit ka pasur një debat rreth përzgjedhjes së një formule zgjedhore, e cila mund të jetë një sistem i pastër proporcional kombëtar. Ç'mendim keni ju rreth një mundësie të tillë?**

Është një përgjigje shumë e ngjashme. Është mirë nëse krahasohen modelet e ndryshme që ekzistojnë sot nëpër botë.

**Pyetje: Do të ishte një model i mirë për t'u vënë në zbatim?**

Të gjithë këto modele ose le të themi shumica e tyre u shërbejnë qëllimit të demokracisë. Pra, gjithçka varet nga rasti në rast. Gjëja më e rëndësishme është që të mos përpiqemi për t'i bërë gjërat më të komplikuar. Zakonisht gjërat e thjeshta janë ato që funksionojnë edhe më mirë. Ky do të ishte një rekomandim i përgjithshëm i imi kur bie fjala për shembull për numrin e kutive të votimit. Përpiquni t'i bëni gjërat sa më të thjeshta dhe keni për të parë se kanë për të funksionuar më mirë.

**Pyetje: Me sa kujtoj nga karriera ime në gazetari, Z. Ambasador, përpara çdo procesi zgjedhor partitë politike shqiptare angazhoheshin në bërjen e një reforme zgjedhore të minutës së fundit, duke bërë që kodi zgjedhor të ndryshohej për çdo palë zgjedhje. Sipas mendimit tuaj, pas gjithë këtyre arnimeve e riparimeve përse nuk kemi ende vallë një kod elektoral të zbatueshëm në Shqipëri, ose si ka mundësi që nuk kemi gjetur ende më të mirin e mundshëm për vendin tonë?**

Kjo mund të kuptohet më lehtë nëse mendojmë se çfarë është e nevojshme për të bërë një ligj apo rregullore me synimin që ky të jetë sa më funksional. Ajo çka nevojitet në këtë rast është pasja e vullnetit të mirë që ky ligj apo rregull të jetë sa më funksional. Do të dëshiroja të shihja më shumë vullnet të mirë të kësaj natyre në të ardhmen, sepse nuk ka pasur të tillë vullnet të mjaftueshëm në të kaluarën. E kam thënë edhe më herët se ligji ekzistues zgjedhor është i mirë për të mbajtur zgjedhje, madje do të ishte i mirë për të mbajtur zgjedhje të tjera në të ardhmen. Mirëpo, për ta bërë sistemin më të sigurt, më transparent, më të kuptueshëm, si dhe më të lehtë për t'u menaxhuar nevojitet reformimi i kodit zgjedhor, reformim i cili duhet respektuar më tepër. Ja pse dëshiroj t'i kthehem sërish konceptit të vullnetit të mirë: vullneti i mirë për t'i përmbushur afatet, vullneti i mirë për të emëruar komisionerët zgjedhorë, këta vullnetarë të cilët mbajnë gjithë barrën e punës gjatë zgjedhjeve. Janë të gjitha këto gjëra të vogla që bëjnë një palë zgjedhje të suksesshme. Dhe duhet thënë se ka pasur përparim edhe në zgjedhjet e fundit.

**Pyetje: Z. Ambasador, në qoftë se do të kishim përpara nesh një kalendar të hapave që duhen ndërmarrë nga klasa politike për reformën zgjedhore, cila duhet të ishte dita e parë e tij?**

Një kalendar?

**Pyetje: Mos vallë dita e djeshme?**

Do të ishte një gjë e mrekullueshme po të ndodhte kështu por natyrisht duhen ndërmarrë hapat e nevojshëm proceduralë në kuvend. Mirëpo, kuptohet që sa më shpejt që të ishte e mundur aq më mirë do të ishte! Sa më shpejt që të jetë e mundur!

**Pyetje: Në vitin 2012, pra vitin tjetër, Kuvendi do të zgjedhë Presidentin e ri të Republikës. Mirëpo, tashmë kanë filluar debate, jo vetëm nëse duhet zgjedhur apo jo sërish Presidenti aktual, por edhe nëse duhet ndryshuar metoda për zgjedhjen e tij. Në fakt, po debatohet rreth zgjedhjes së drejtpërdrejtë të Presidentit, pra, me anë të votës popullore. Sipas mendimit tuaj, cila do të ishte zgjidhja më e mirë për vendin tonë?**

Tani ne ndodhemi më pak se 12 muaj larg zgjedhjes. Kështu që një ndryshim kaq rrënjësor mbase nuk do të ishte i këshillueshëm në këtë kohë. Kjo sepse për të, ashtu si edhe për kodin zgjedhor, apo për çfarëdolloj reforme tjetër, si ajo gjyqësore apo edhe e shërbimit civil, do të nevojitej një debat i shëndoshë. Unë e kuptoj plotësisht idenë që Shqipëria t'i bashkohet një numri të madh vendesh të rajonit të cilët e zgjedhin Presidentin me votë të drejtpërdrejtë. Është një ide me vlerë, por gjithashtu duhet pasur parasysh nëse pas këtyre ndryshimeve Presidenti duhet të kufizohet kryesisht në një post ceremonial, apo nëse atij duhet t'i shtohen edhe funksione të tjera vendimmarrëse, të cilat nuk parashikohen ende në kuadrin e këtij posti, apo që kanë qenë parashikuar dikur në kuadrin e tij. Për sa i përket procedurës siç parashikohet në kushtetutë, duhet pasur parasysh se rregullat e reja nuk janë vënë ende në përdorim, as edhe një herë të paktën, dhe për këtë arsye duhen provuar. Për mua personalisht, nëse më lejoni të shpreh mendimin tim rreth kësaj çështjeje, ajo çka do të dëshiroja të shihja tani është nisja e diskutimeve dhe debateve se kush mund të jetë kandidati apo kandidatët më të mirë. Kjo është një gjë shumë e rëndësishme sepse ky person është numri një i shtetit, ndaj përzgjedhja e tij duhet bërë në një mënyrë jopartizane, mbi nivelin e partive politike, ky, pra, është elementi më i rëndësishëm, dhe për këtë nevojitet një figurë e shquar. Mund të jetë Presidenti aktual, por mund të jetë edhe një kandidat tjetër. I takon popullit dhe partive politike të shohin se kush i plotëson kushtet për të qenë Presidenti i ardhshëm.

**Pyetje: Sipas mendimit tuaj, a mos duhet të jetë ky një kandidat konsensual duke qenë se shumica nuk ka nevojë për ndihmë për sa i përket votave që nevojiten për zgjedhjen e tij. Ata i kanë të gjitha votat që u duhen për të zgjedhur Presidentin e ri. A mendoni se numri i votave nuk duhet të jetë i rëndësishëm kur zgjidhet Presidenti i ri, por se duhet bërë një përzgjedhje më e gjerë për të pasur një President sa më konsensual?**

Mendoj se kushtetuta flet qartë në lidhje me këtë pikë, pra, që në tre raundet e para të votimit nevojitet një shumicë e cilësuar votash. Një gjë e tillë do të dëshmonte konsensusin e palëve dhe prandaj dua ta ritheksoj atë që e shpreha më herët në formë ftese: kërkoni sa më intensivisht që të jetë e mundur për një apo disa kandidatë të mirë dhe kështu nuk ka për t'u nevojitur raundi i katërt i votimit, i cili parashikon shumicë të thjeshtë votash dhe aq më pak do t'ju nevojitet një raund i pestë. Rrjedhimisht, instrumentet ekzistojnë, por gjithçka varet nga fakti se cili do të jetë kandidati ose kandidatët.

**Pyetje: Qarkullojnë disa emra në media për këtë detyrë. Ndër ta janë edhe disa emra grash. A mendoni se Shqipëria është gati për të pasur një presidente grua?**

Përse jo, përse jo! Burrë apo grua, kushdo mund të përzgjidhet, mjafton që të ketë staturën e duhur për këtë post, si dhe të mbajë qëndrim të pavarur mbi palët. Patjetër!

**Pyetje:** Lëmë tashmë sferën e politikës reale për të prekur disa probleme që mbase janë edhe sociale dhe jo vetëm të tilla. Disa probleme këto që sipas opozitës kishin të bënin edhe me zgjedhjet. E kam fjalën për tragjedinë e 21 Janarit. Në raportin tuaj thuhet tekstualisht: “Se si ndodhën këto vdekje dhe identifikimi i personave përgjegjës duhet të jetë fokusi i hetimeve që tashmë janë në proces e sipër”. Mirëpo, “deri tani, as Prokuroria e Përgjithshme dhe as komisioni hetimor parlamentar nuk kanë qenë në gjendje të dalin me ndonjë rezultat të prekshëm”. A keni ndonjë koment në këtë drejtim? A i keni pyetur këta zyrtarë, qofshin të qeverisë apo të opozitës, se çfarë po ndodh me këtë hetim?

Kemi bërë aq sa kemi mundur, duke respektuar një hetim në zhvillim e sipër. Po ashtu edhe partnerët tanë, e pikërisht SHBA, kanë mbështetur një hetim të shpejtë të çështjes. Kjo është padyshim e nevojshme dhe dëshirojmë të shohim më shumë rezultate në këtë drejtim, kuptohet rezultate të sakta. Është diçka që u detyrohemi familjeve të viktimave, por edhe opinionit të gjerë publik, për transparencë dhe për të hedhur dritë përfundimisht mbi atë se çfarë ndodhi në të vërtetë më 21 Janar.

**Pyetje:** Mendoni se vonesat për përfundimin e këtyre hetimeve janë normale?

Është një periudhë vërtetë e gjatë! Tani jemi në Shtator, pra, kanë kaluar plot 8 muaj. Këto ishin incidente të rënda, dhe ndoshta incidente edhe më pak të rënda kërkojnë kohë. Megjithatë, duhet bërë me shumë urgjencë.

**Pyetje:** Lexova gjithashtu në raportin tuaj se ndërsa në të gjitha demokracitë bashkëkohore, koalicioni qeverisës ka të drejtën politike për të qeverisur, nevoja për ta përfshirë opozitën në proceset politike është megjithatë e një rëndësie jetike. Si po e ndikon demokracinë shqiptare ky parim i pazbatueshëm? Si mendoni se mund të kapërcehet një situatë e tillë?

Epo, përmes dialogut! Qeveria zgjidhet nga shumica, kështu që kjo është një e drejtë politike apo jo? Mirëpo, kemi të bëjmë gjithashtu me një të drejtë ligjore sepse parashikohet në kushtetutë, dhe kështu ata që janë në qeveri apo që bëjnë pjesë në koalicionin qeverisës gëzojnë të drejtën e plotë për të qeverisur. Mirëpo, në bazë të kushtetutës vjen një moment që edhe Opozita bëhet pjesë e qeverisë, sepse mund të ndodhë shpesh që nevojitet një shumicë e cilësuar në parlament. Ja pse është kaq i rëndësishëm dialogu përmes konsensusit, duke folur hapur, duke paraqitur në mënyrë konstruktive propozime të mira, si dhe duke pranuar faktin se nuk mund të gjendet një përgjigje 100 % e gatshme vetëm nga njëra palë. Pra, bëhet fjalë për palët që të mblidhen bashkë dhe të identifikojnë interesin madhor të popullit, i cili në rastin tonë është që të bëhen përparime me axhendën e reformave, duke bërë hapa përpara drejt integritimit evropian të vendit, dhe për këtë nevojiten të dyja palët. Dëshiroj të ripërmend atë që thamë më sipër: demokracia është me rrota, pra, qeveria mund të kalojë në opozitë në të ardhmen, çka e bën atë sërish të nevojshme, ndërsa opozita të marrë pushtetin duke u kthyer në qeverinë e radhës, kështu që gjërat duhen parë në këndvështrimin e krijimit të një partneriteti për të mirën e shqiptarëve.

**Pyetje:** Dhe sigurisht të gjithë shpresojmë se një gjë e tillë do të ndodhë një ditë.

**Pyetje:** Dhe ja ku u kthjem për të vazhduar intervistën tonë me Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadori Eugen Wollfarth. Z Ambasador, megjithëse Shqipëria, thoni ju në raportin tuaj, është angazhuar për miratimin e rregullave

**specifike për rritjen e transparencës publike dhe konsultimit gjatë procesit ligjvënës, një gjë e tillë vazhdon të bëhet në mënyrë selektive. Cilat janë pasojat e mosfunksionimit të rregullave të transparencës?**

Pasojat janë që publiku duhet të informohet në mënyrën më të mirë të mundshme apo të ketë qasjen më të mirë të mundshme në informacion. Sigurisht media luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, por jo çdo gjë duhet t'i lihet në dorë medias, sepse bëhet fjalë për informacione të cilat kanë të bëjnë me mënyrën se si zhvillohet procesi vendimmarrës, si funksionojnë autoritetet, apo si procedohet me kërkesat ligjore. Është një çështje tepër e rëndësishme. Transparenca është jashtëzakonisht e rëndësishme për të kuptuar demokracinë. Është po ashtu e rëndësishme për menaxhimin e mirë të institucioneve sepse ka të bëjë me zbatimin e rregullave, një term ky që është sinonimi i korrupsionit apo i anti-korrupsionit në rast se zbatohen rregullat, dhe po ashtu është një transparencë për sa i përket mënyrës se si merren vendimet, dhe një gjë e tillë e bën korrupsionin automatikisht më të vështirë për të ndodhur, madje në disa raste e përjashton fare mundësinë që ai të ndodhë. Një gjë e tillë do të ishte shumë e rëndësishme.

**Pyetje: Dhe transparenca është një element i rëndësishëm i sistemit demokratik. Po për sa i përket llogaridhënies? Si e shihni atë në situatën aktuale në vend? A kemi institucione publike që japin llogari për veprimtarinë e tyre të përditshme?**

Dëshiroj t'i përgjigjem pyetjes tuaj duke e përqendruar vëmendjen tek Kuvendi. Atje mbledhen deputetët e zgjedhur nga të gjitha partitë politike, të cilët e përmbushin funksionin e tyre jo vetëm në seancat plenare, por edhe duke punuar nëpër komisione, çka do të thotë shpenzimet publike kontrollohen imtësisht nga më shumë se një palë, përfshirë këtu edhe Opozitën. Ky është një vend i rëndësishëm për të pasur një nivel të lartë transparence, por edhe kontrole e balanca me qëllim të bëhet kujdes që paratë e taksapaguesve të shpenzohen në mënyrën e duhur. Dhe një gjë e tillë automatikisht të çon drejt një shkalle më të lartë llogaridhënieje.

**Pyetje: Përpara se të kaloj në një pyetje që ka të bëjë drejtpërdrejt me deputetët dhe imunitetin e tyre, ç'mendim keni për faktin se gjatë 20 viteve demokraci shqiptare nuk ka pasur asnjë zyrtar të lartë a ministër që të jetë gjykuar për korrupsion ose një vepër penale të ngjashme?**

Nuk mund të pretendoj se jam një historian, i cili i njeh të gjitha aspektet e jetës në vend dhe veçanërisht të asaj të figurave të rëndësishme. Po ashtu nuk dëshiroj të bëj shakaxhiun duke thënë se mbase asnjëri prej tyre nuk ka bërë ndonjë gjë për të përfunduar në burg. Mirëpo, mund të ketë shumë gjasa që të ketë ndodhur një rast i tillë dhe personi në fjalë të jetë mbrojtur me anë të imunitetit, ja pse është e rëndësishme që të ekzistojnë mekanizmat përkatës kur ka arsye të forta për t'u besuar se është kryer një krim dhe se duhet hequr imuniteti përmes një procedure të mirëpërcaktuar, për shembull të ngjashme me ato që zbatohen në Kuvend, e cila duhet zhvilluar me një nivel të lartë transparence dhe duke përfshirë edhe Opozitën.

**Pyetje: Pra, ju sugjeroni heqje të plotë imuniteti për deputetët?**

Gjithçka varet nga rastet e veçanta. Imuniteti nuk u shpik për ta bërë më të lehtë biznesin e deputetëve, por për të garantuar pavarësinë e tyre në punë. Kur përdoret në mënyrën e duhur, në disa rrethana të caktuara, ai mund dhe duhet të hiqet. mirëpo, për vetë origjinën e tij në

shumë vende, në shumë demokraci të vjetra, imuniteti është një instrument tradicional për mbrojtjen e deputetëve, për t'u siguruar që nuk mund të vihen nën presion dhe të mund të vendosin lirisht si përfaqësues të zgjedhur të popullit dhe në të mirë të përparimit të vendit.

**Pyetje: Mirëpo mbetet edhe një shqetësim që e kam gjetur të shprehur në raportin tuaj se “miratimi nga ana e Kuvendit e një dispozite të tillë mbetet i hapur për debat, pasi deklarata mund të kthehet në një pengesë për ndjekje të mundshme penale”?**

Në qoftë se kryhen vepra penale ato natyrisht duhen hetuar...Dhe kur ndjekja penale nuk është e mundur për shkak të imunitetit, atëherë padyshim duhet vendosur ai mekanizëm për të përcaktuar hapat përkatës.

**Pyetje: Pra, të përcaktohet hap pas hapi.**

Po. Kjo qartësisht nuk ka të bëjë me heqjen e imunitetit. Ky është një element i rëndësishëm për një punë të mirë në shumicën e demokracive, por duhet përdorur si duhet.

**Pyetje: Përsëri, kam një temë tjetër që ka zënë një vend të rëndësishëm në raportin tuaj, çështja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe ajo çfarë ndodhi mes parlamentit dhe kandidatëve të propozuar nga President i Republikës. “Kuvendi tani duhet t'i japë një zgjidhje kësaj çështjeje,” thoni ju në raportin tuaj. Cili është komenti juaj për këtë? Cila është zgjidhja?**

Kushtetuta ka disa dispozita të cilat, nëse lexohen së bashku, duket se mundësojnë një zgjidhje, por përsëri do të binte në kundërshtim me frymën e Kushtetutës dhe me nevojën për të emëruar gjyqtarët në mënyrën e duhur. Si rrjedhojë, për të arritur një zgjidhje, Kuvendi duhet të bashkohet për të marrë një vendim të përbashkët i cili, në këtë rast bëhet patjetër me shumicë të cilësuar, duke gjetur kështu një gjuhë të përbashkët mes palëve. Mendoj që kjo është shumë e rëndësishme dhe kam përshtypjen si shumë të tjerë që këta gjyqtarë duhen emëruar sa më parë të jetë e mundur, por sigurisht pa thyer rregullat. Përmes Kushtetutës, Kuvendi ka fuqinë, kur ka shumicën e nevojshme, që të përshtatë rregullat, dhe kur kjo bëhet pas një diskutimi publik dhe me transparencë, jo vetëm që përmbushet fryma e Kushtetutës, por edhe gjyqtarët e kanë rrugën të lirë për t'u emëruar.

**Pyetje: Z. Ambasador, me sa jeni ju në dijeni, mendoni se politika ndërhyr në sistemin e drejtësisë, duke votuar në favor apo kundër njërit gjyqtar apo tjetrit?**

Nuk kam parë në fakt ndonjë rast serioz gjatë mandatit tim këtu 12 muajt e fundit, por ndonjëherë bëhen publike mendime të tilla që mund të ndikojë gjyqtarët, por gjithsesi ata normalisht duhet të jenë aq të pavarur sa t'i shpërfillin këto mendime. Çështja është kur ka përfshirje në korrupsion, dhe jo vetëm me fjalë, megjithatë kjo nuk është shumë e qartë për ne.

**Pyetje: Pse?**

Kuptohet. Kush do të tregonte në gazetë apo televizion se çfarë po bën apo jo?

**Pyetje: Por burimet tuaja nuk vijnë vetëm nga gazetatat.**

Jo vetëm, saktë. Është e vërtetë.

**Pyetje: Javën e kaluar, z. Ambasador, një gjyqtar shqiptar u ekzekutua në një atentat të tmerrshëm, besoj e keni parë. Ishte i parë në njëzet vjet demokraci tek ne. Autoritetet shqiptare e konsideruan si një sulm mbi shtetin. Ju si e perceptoni?**

Ky është një incident tronditës dhe absolutisht i papranueshëm. Është një krim, është një vrasje, dhe sigurisht që duhet jo vetëm të hetohet plotësisht por edhe të dënohet plotësisht. Kjo qartësisht nuk ndihmon respektin për rendin e së drejtës, por kjo nuk është Shqipëria. Uroj të mbetet një incident i izoluar dhe unë e dënoj hapur.

**Pyetje: Z. Ambasador, edhe publiku i ka ndjekur deklaratat tuaja në të kaluarën në lidhje me vonesat gjyqësore të çështjes së *Gërdecit*, dhe në raportin tuaj ju thoni që publiku mbetet i zhgënjyer dhe i lodhur nga zvarritja e kësaj çështjeje. “Kjo situatë meriton disa përgjigje konkrete, në mënyrë që të nxirren disa mësimë”. Z. Ambasador, ia keni bërë këtë pyetje autoriteteve shqiptare?**

Po, ua kemi bërë, dhe gjithashtu kemi vepruar mbi mësimet e nxjerra. Së pari, për dy vjet që pas incidentit, ne kemi mbështetur Ministrinë e Mbrojtjes për t’i trajtuar municionet e vjetra të tepërta dhe lëndët kimike në një mënyrë të përshtatshme dhe kjo është shumë më e sigurt. Nuk ka ndodhur më një incident i tillë, sigurisht jo në ato përmasa, dhe tani bëhet në një mënyrë profesionale, të sigurt dhe të përgjegjshme. Duhej të ishte bërë më parë. Ne në fakt e bëjmë këtë jashtë mandatit tonë. Sa i përket vetë çështjes së *Gërdecit*, duket se po luhet shumë me sistemin, pasi nuk janë vetëm gjyqtarët përgjegjës për një çështje, por ka dhe të tjerë që kontribuojnë. Dhe një rol i rëndësishëm është ai i avokatëve, dhe sigurisht ata duhet të marrin pjesë në seancat gjyqësore dhe mos ta zvarrisin çështjen duke munguar dhe duke mos marrë pjesë në seanca, pasi kjo ka sjellë shumë vonesa. Familjet dhe viktimat sigurisht, por siç kam thënë edhe në raste të tjera, edhe publiku i gjerë ka të drejtën të mësojë se çfarë ka ndodhur dhe të shohin ata që janë përgjegjës të dënohen, në rast se shpallen fajtorë pas një procesi të duhur.

**Pyetje: Dhe besoj që edhe familjet e viktimave duhet të mësojnë se kush është përgjegjës për humbjen e tyre. Por duhet të theksoj edhe një herë të njëjtën pyetje. Cila ishte përgjigja që ju kanë dhënë autoritetet shqiptare kur i keni pyetur për këto vonesa?**

Është çështje procedurash. Sigurisht që të pandehurit kanë të drejtë që të kenë avokatët e tyre të pranishëm, por nëse ata nuk paraqiten, kjo sjellë vonesa dhe pakënaqësi. Unë e kam bërë publike këtë çështje dhe për një farë kohe pati disa përmirësime, por tani duhet të përfundojë medoemos, duke ndjekur sigurisht rregullat. Kjo është shumë e rëndësishme.

**Pyetje: Një tjetër problem që ju e përmendni në raportin tuaj është reforma e pronës. “Investimet dhe huamarrja private dhe publike vazhdojnë të pengohen për shkak se jo në të gjitha rastet mund të garantohet pronësia. Aktualisht, u dhënë zgjidhje pretendimeve të vetëm pak ish-pronarëve”. Duket se është një nga problemet më të mëdha të shqiptarëve tani. Kush duhet të mbajë përgjegjësi për këtë çështje të pazgjidhur në Shqipëri, z. Ambasador, sipas jush?**

Përgjegjësia, sigurisht, është e autoriteteve të shtetit shqiptar. Që nga viti 1991 Shqipëria është një vend demokratik, por periudha e mëhershme është një burim i madh i pështjellimit që shohim tani, që nga koha e regjimit të kaluar apo qoftë dhe më përpara. Por përgjegjësia mbetet tek autoritetet shtetërore. Ajo që ne bëjmë me mbështetjen e BE-së, dhe ajo që bëjmë

ne si Prezenca e OSBE-së, është që ndihmojmë në sigurimin dhe mbledhjen e informacionit dhe të hartave, në mënyrë që autoritetet shtetërore shqiptare të mund të vendosin se kujt t'ia japin një titull toke apo prone. Kështu, përgjigja është shumë e qartë: u takon autoriteteve shtetërore shqiptare. Sigurisht, analiza duhet bërë në mënyrë shumë të kujdesshme dhe nuk është diçka që bëhet shpejt, prandaj kërkon goxha kohë.

**Pyetje: Mund të na tregoni pak më shumë se çfarë ju shtyu të bashkëpunimit me BE-në në projektin e regjistrimit të pronave në jug të vendit? Mund të na tregoni pak më shumë për projektin?**

Është një zonë e rëndësishme, dhe është Banka Botërore që po luan rol në pjesët më urbane. Por kjo zonë në jug ka rëndësi për zhvillimin ekonomik dhe për investitorët. Është një zonë turistike ndaj është e nevojshme të ketë siguri për titujt e pronësisë, ndryshe investitorët do të ngurrojnë, dhe në këtë mënyrë ulen dhe mundësitë e punësimit për banorët e zonës.

*(Commercial break)*

**Pyetje: Dhe ja ku u kthym z. Ambasador, për të diskutuar pjesën e fundit të intervistës sonë, e cila ndoshta do të jetë dhe më e rëndësishmja sepse do të flasim për përjetimet tuaja si një njeri i zakonshëm, dhe jo si një ambasador në Shqipëri. Por përpara kësaj, të prekim edhe një herë një temë interesante siç është korrupsioni. Ju shpreheni në raport se "ndjekja e zyrtarëve të lartë shtetërore të akuzuar për korrupsion vazhdon të mbetet një problem". Pse mendoni se lufta kundër korrupsionit është pothuajse një betejë e humbur, të paktën deri tani, në Shqipëri?**

Në fakt, nuk kam përdorur ndonjëherë këto fjalë...

**Pyetje: Jo, këto janë fjalët e mia...**

Korrupsioni duhet luftuar. Sigurisht që është një detyrë komplekse sepse duket se ka prekur çdo sektor. Kështu që është detyrë gjithëpërfshirëse ku edhe media mund të ndihmojë së bashku edhe me interesimin e publikut. Sjellja e publikut, qoftë e individit apo të sipërmarrjeve mund të ketë ndikim duke mos pranuar të japin para. Të paguajnë vetëm detyrimet e nevojshme për shërbimet e ofruara sipas rregullave, as më shumë e as më pak. Ndryshe do të ishte një situatë e humbur për të gjithë, sepse kur futet korrupsioni pjesa e tortës në fakt zvogëlohet në vend që të zmadhohet, as nuk qëndron në vend, por zvogëlohet, sepse vetëm një numër i vogël njerëzish marrin një shërbim të caktuar, të tjerët përjashtohen edhe pse i paguajnë detyrimet për atë shërbim. Kjo sjell shqetësim, dhe jo zhvillim të mirë. Është gjithashtu pengesë për investitorët të cilët kërkojnë rregulla të qarta dhe fitime të mira nga investimet.

**Pyetje: Mendoni se ka ardhur koha që autoritetet shqiptare të ndryshojnë mënyrën e trajtimit të këtij problemi?**

Mund të diskutohet. Sigurisht që mund të rritet shkalla e ndërgjegjësimit, por besoj se ka filluar të luftohet dhe nuk duhet të tërhiqen, por duhet të vazhdojnë të luftojnë këtë fenomen në të gjitha nivelet. Nuk është vetëm detyrë në nivel qendror, por edhe në nivel vendor – detyrë e komunitetit. Siç e përmenda, duket se nuk mund të përjashtojmë ndonjë sektor, kështu që kushdo duhet të tregohet i ndërgjegjshëm. Ndonjëherë është i pranishëm edhe

brenda një kompanie private – sepse shpesh harrohet se ky fenomen ekziston edhe në sektorin privat, dhe është shkatërrues.

**Pyetje: Meqë po flasim për sipërmarrjen, nuk mund të lemë pa përmendur edhe median – një faktor shumë i rëndësishëm për mbarë zhvillimin e vendit. Në raportin tuaj thuhet se "qeveria është në gjendje të "inkurajojë" disa media më shumë se të tjerat, ose duke u dhënë në mënyrë selektive reklama publike, ose duke përdorur dispozita të veçanta në kontrata qiradhënieje, etj..." Mund të tregoheni më konkret z. Ambasador?**

Mendoj se ajo çfarë cituat ishte konkrete. E rëndësishme është që media të ketë akses te politikanët dhe eventet publike, të mund të raportojë, dhe të raportojë në mënyrë të ekuilibruar. Por sigurisht që përveç raportimit të ngjarjeve, mund të bëhet dhe komentim, dhe kjo vjen nga këndvështrime të ndryshme politike, dhe publiku i gjerë ka mundësinë të zgjedhë se cilën media të ndjekë. Kjo është e rëndësishme. Kur bëhet fjalë për taksapaguesit, buxheti i shtetit për pjesën e shërbimeve të tilla si reklamat apo informacionet që u shpërndahen medie, shpërndarja të bëhet në mënyrë të tillë që të mos ketë mungesë ekuilibri. Kjo mund të varet nga madhësia e medias – një televizion i madh mund të marrë më shumë spote publicitare sesa një televizion i vogël, por duhet të ketë transparencë dhe një shpërndarje të barabartë, dhe jo t'i jepet vetëm një televizioni, apo vetëm televizionit publik. Kjo do të konsiderohej si mungesë ekuilibri.

**Pyetje: A është OSBE-ja e shqetësuar për pavarësinë e medias në Shqipëri?**

Është një çështje e rëndësishme, që e ndjekim vazhdimisht. Ka liri të medias në Shqipëri, dhe kjo është shumë e rëndësishme. Ky është një nga aspektet pozitive të jetës publike – këndvështrimet e ndryshme - dhe kjo ka rol thelbësor jo vetëm në kohë zgjedhjesh, por edhe për demokracinë në përgjithësi. Por sigurisht që ka edhe shqetësime kur bëhet fjalë për një çështje kaq të rëndësishme. Zhvillimet e fundit po drejtohen kundër lirisë së medias? Apo në favor të medias? A kanë sadopak ndikim te media? Ne vëzhgojmë nga afër çfarë ndodh dhe përpiqemi të asistojmë kur është e nevojshme për të garantuar se gjërat ecin në rrugën e duhur.

**Pyetje: Z. Ambasador, gjatë një viti pune dhe të jetuari në Shqipëri, keni qenë gjithashtu edhe në lëvizje në vend dhe jashtë Shqipërisë. Por cila është, sipas mendimit tuaj, pika më e dobët e Shqipërisë dhe shqiptarëve?**

Vështirë të thuhet. E kam më të lehtë të përmend pikën më të fortë, që është optimizmi dhe mikpritja e ngrohtë që ndjeva, por do të thoja optimizmi. Vendi ka bërë shumë progres gjatë 20 viteve të fundit. Pas ardhjes së demokracisë, ka parë zhvillim të madh ekonomik, por duket qartë se populli ka nevojë për më shumë dhe për mundësi më të mira pune. Besoj se do t'ia arrijnë. Kjo ka lidhje me edukimin. Më pëlqen gjithashtu që prindërit, jo vetëm ata që kanë mundësitë financiare, por që prindërit në përgjithësi duan t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollat të mira, dhe mendoj se në këtë aspekt shqiptarët janë shumë normal. Pikat e dobëta...do t'i kthehem kësaj më vonë. Por do të doja që shqiptarët të ndiheshin më krenar për veten. I kanë të gjitha arsyet për këtë. Ky është një vend i mrekullueshëm. Sigurisht që ka ende nevojë për shumë përmirësime. Dhe nuk është vetëm një gropë në rrugë që duhet rregulluar, por është një punë komplekse, është, për shembull, i gjithë sistemi i kanalizimeve. Përmenda edhe arsimin. Ka shumë gjëra që mund të përmirësohen edhe më tej, por kjo duhet parë edhe nga ana pozitive. Përmirësimi kërkon profesionalizëm në punë, dhe kjo do të

krijonte mundësi për më shumë të ardhura. Pra ka arsye të jemi optimist sepse ka ende punë për të bërë. Por mund ta bëni këtë me krenari që kombi të ecë përpara dhe të krijohen mundësi të mira pune. Por nga ana tjetër, nuk më pëlqen të pranoj që jetojmë në një botë konkurruese...

**Pyetje: Por në fakt jetojmë...**

... dhe Shqipëria kërkon të integrohet në Evropë dhe përgatitja për të qenë konkurruese fillon me edukim dhe formim të mirë. Kështu që nxitja ime është të punohet në këtë drejtim.

**Pyetje: Do ju pyes për një tjetër përshtypje personale. Mendoni se mungesa e dialogut mes politikanëve shqiptarë është tipar i politikës shqiptare apo tipar i shqiptarëve si individë?**

Ka ndodhur në Shqipëri, por mund të ndodh edhe diku tjetër. Por gjatë kësaj periudhe duhet bërë pyetja nëse vërtet është e nevojshme. Mua më pëlqen më tepër t'i hedh sytë nga e ardhmja. Ndoshta ndonjëherë është mirë të qëndrosh në vend/t'i lësh gjërat pezull për pak kohë dhe të shtysh gjetjen e një zgjidhje. Por unë kam përshtypjen, dhe bindem gjithmonë e më tepër për këtë, se klima po ndryshon për mirë dhe do të shohim progres.

**Pyetje: Të kalojmë tani në përvojën tuaj personale gjatë këtij viti në Shqipëri. Keni udhëtuar pothuajse nëpër të gjithë vendin dhe media ju ka ndjekur. Si zgjidhni se cilën pjesë të vendit të vizitoni dhe cilat janë përshtypjet tuaja nga udhëtimet nëpër Shqipëri?**

Shqipëria është një vend i bukur – mahnitësh kur viziton rrethet e ndryshme dhe nga takimet me kryetarë bashkie, kryetarë këshillash qarku apo edhe me prefektin dhe me banorët e zonës. Në shumicën e rasteve, kam pasur përshtypje shumë të mirë dhe është bukur të shohësh vendin që ecën përpara. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka edhe katër zyra projektesh jashtë Tiranës, për të ndihmuar që të ketë progres në mbarë vendin dhe jo vetëm në kryeqytet. Në këtë mënyrë, kur bëhet fjalë për integrimin e vendit, për lirinë e medias, për vende pune, për arsimin... të mund të ofrohet një shërbim i ngjashëm ose edhe më i mirë në të gjithë vendin, si në bashkitë e tjera, ashtu edhe në kryeqytet. Këto vizita shërbejnë për t'u informuar dhe për të dhënë këshillat e duhura, si dhe për të siguruar asistencën e duhur për ta çuar vendin përpara.

**Pyetje: Kur ju pyeta për pikat e dobëta, ju më dhatë një përgjigje pozitive, dhe flisni për optimizëm. Por çfarë tjetër ju pëlqen më shumë nga Shqipëria dhe shqiptarët, përveç optimizmit?**

Përveç optimizmit, që mbetet cilësia e preferuar për mua, është të qenit aktiv. Shumica e shqiptarëve që kam takuar janë njerëz aktiv – u pëlqen të punojnë dhe të jetojnë. Por nuk mund të lë pa përmendur përsëri optimizmin, ndoshta sepse edhe vetë jam optimist. Kur beson se mund të lëvizësh ujërat, mund t'ia dalësh mbanë, dhe unë mendoj se shqiptarët munden. Shumë shqiptarë, dhe unë mendoj se kjo dihet, janë të suksesshëm dhe bëjnë një punë shumë të mirë në vende të tjera, qoftë në SHBA, Gjermani, Itali apo Greqinë fqinje. Nëse e njëjta gjë do të ndodhte edhe në Shqipëri, atëherë nuk shoh ndonjë pengesë pse të mos ketë zhvillim të mirë në vend.

**Pyetje: Për ta mbyllur, në raportin tuaj thuhet se viti tjetër, duke filluar në fakt që tani, por veçanërisht viti tjetër do të tregojë se ku duan ta çojnë Shqipërinë liderët e saj politik. Ju thoni se zgjedhja është e thjeshtë – dialog dhe reforma ose qëndrim në vend. Si do të ndikojë zgjedhja e politikanëve shqiptarë në marrëdhënien me OSBE-në?**

Nëse bëhet progres i mirë drejt integritimit evropian, kjo tregon se reforma nuk është bërë vetëm në letër, por edhe me vepra. Do të thotë se Shqipëria do të jetë një vend shumë më i zhvilluar nga ç'është sot. Do të ishin përmbushur angazhimet e vendeve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe prania jonë në vend do të ishte më pak e nevojshme – dhe besomëni, ky do të ishte një lajm i mirë.

**Pyetje: Ndodhemi në ambientet e një televizioni. Në emër të Ora News dhe radios ju falënderojmë që ishit i pranishëm këtu sot, në përvjetorin tuaj të parë si Ambasador i OSBE-së në Shqipëri. Një përshtypje e shpejtë, ndoshta, për televizionin Ora News?**

E shoh shpesh. Ndonjëherë gjatë ditës, për të ndjekur se çfarë po ndodh në vend, dhe shoh se përcjell një frymë të mirë. Më pëlqen që transmeton *live*, që përcjell informacion të mirë, dhe veçanërisht titrat në anglisht, të cilët më ndihmojnë të kuptoj. Ndoshta një ditë mund të vendosni titra edhe në gjermanisht, dhe kjo do të ishte edhe më e lehtë për mua. Por vërtet që më ka ndihmuar mjaft deri tani. Më pëlqen!

**Pyetje: Do ta diskutojmë këtë sugjerim me Presidentin e televizionit. Ndoshta kur të dëgjosh për titrat në gjermanisht, do ta realizosh edhe këtë mundësi. Unë personalisht ju falënderoj që pranuat ftesën për të ardhur në studion time përsëri, e cila sigurisht do të jetë gjithmonë e hapur për ju, për të diskutuar zhvillimin e reformave dhe veçanërisht progresin e Shqipërisë dhe shqiptarëve. Faleminderit, z. Ambasador!**

Faleminderit juve, Ilva Tare. Ishte kënaqësi prania në këtë studio, sidomos në një ditë të veçantë si kjo – plot një vit në Shqipëri. Ka qenë një vit fantastik. Faleminderit!

**15 Shtator 2011**